



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. _____

Tiranë ____/____/2026

VENDIM

Nr. 9, datë 19.03..2026

PËR
MIRATIMIN E STRATEGJISË SË NDËRGJEGJËSIMIT TË PUBLIKUT
NË AGJENCINË E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të nenit 27, pikat 1 dhe 2, të nenit 43, pika 1, shkronjat “dh” dhe “e”, të nenit 52, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 9, pika 3 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 6/1, shkronja “e” të Rregullores nr. 20, datë 25.09.2017 “Për nënshkrimet e autorizuar në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 31 datë 10.10.2025 “Për caktimin e Z. Martin Blushi, zëvendës drejtor i përgjithshëm, për të ushtruar kompetencat për mbarrëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, deri në emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm”, të nenit 18 pika 2 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014, si dhe me propozim të Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Strategjisë së ndërgjegjësimit të publikut në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për zbatimin e kësaj strategjie.
3. Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 7, datë 20.03.2016 për miratimin e “Strategjisë së ndërgjegjësimit të publikut” shfuqizohet.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE

Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Rruga e Elbasanit, Nr. 317
Tiranë / Albania
t: +355 (4) 2362 989/2347 298 f: +355 (4) 2362 984
e: info@asd.gov.al w: www.asd.gov.al



Donald Duraj

Kryetar

Shqipe Malaj

Sekretare



AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE

Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Rruga e Elbasanit, Nr. 317
Tiranë / Albania
t: +355 (4) 2362 989 / 2347 298 / f: +355 (4) 2362 984
e: info@asd.gov.al m: www.asd.gov.al